



# Mjedisi radioaktiv vjetor dhe efektet mbi shëndetin

Drnt. Dafina Nazaj  
Prof. As. Dr. Engjëll Liçaj

## Abstrakt

Efektet negative të rrezatimeve radioaktive kanë karakter stokastik. Publikimet mbi korelacionet dozë efektive dhe sëmundje kancerogjene përqëndrohen mbi doza më të larta se 100 mSv/ vit.

Në këtë punim bëjmë përpjekje për ta përqendruar vëmendjen mbi efektet e dozave të ashtuquajtura të dobëta nën 100 mSv/vit.

Ideja jonë është të përdorim modelin Monte Carlo dhe të marrim në konsideratë të gjitha dozat, duke i integruar ato në doza efektive vjetore. Efektet e rrezatimeve jonizuese përfshijnë një gamë të gjerë të reaksioneve shumë të ndryshëm njeri nga tjetri në relacionin dozë-efekt. Manifestimet klinike mund të shtrihen në intervale të ndryshme kohore, gjë që e bën të vështirë përcaktimin e koeficienteve të korrelacionit dozë efektive-sëmundje. Në këtë material kemi bërë një bilancë vjetor rrezatimi me matje mbi Rn<sup>222</sup> në mjedise shkollore, vlerime të rrezatimeve mjekësore, atyre kozmike, të fushave elektromagnetike të antenave dhe të fonit të formacioneve shkëmbore në qytetin e Vlorës për periudhën 2012-2014

Fjalë kyçe: radioaktivitet, dozë efektive, radon, kancer.

## Hyrje


Efektet negative të rrezatimeve klasifikohen në dy kategori të mëdha:

1. Efekte trashëgimie ose efekte gjenetike që manifestohen tek pasardhësit e të ekspozuarve

2. Efekte somatike që manifestohen tek vetë personat e ekspozuar. Këtu kemi parasysh efektet e mprehta të menjëhershme dhe që manifestohen pak mbas ekspozimit të personit ose efekte të vonuara mbi personin e ekspozuar.

Leucemitë shfaqen shumë më herët në krahasim me sëmundjet kancerogjene. Rrezatimet shkaktojnë eksitime dhe jonizime të lidhjeve molekulare të qelizave të ndryshme të indeve të rrezatuara.

Ekspozimi i qelizave kundrejt rrezatimit shkakton prishje të lidhjeve dyshe të urave ADN/ADN dhe të urave ADN/protein.



Zinxhiri AND i dëmtuar nga rrezatimet (yjet e kuq).

Riparimi i lezioneve bën të ndërfiten enzimat më të rëndësishme. Këputjet e thjeshta janë riparuar brenda pak sekondash ose në pak minuta. Të tjera leziona janë të riparuar në disa orë.

Për çdo energji rrezatimi të kapur nga organizmi si rrezatim i jashtëm: rrezatim gamma, X, neutronik, elektromagnetik apo si rrezatim i brendshëm: alfa, gama, kemi llogaritur dozën efektive.

Ndotësit e jashtëm veprojnë mbi organizmin tonë nëpërmjet lëkurës e në brendësi të trupit. Rrezatimet e brendshme futen në organizëm nëpërmjet gjëlltitjes ose nëpërmjet frymëmarrjes. Jeta e njeriut vihet në rrezik çdo ditë nga mjedise ku tejkalimi i pakontrolluar i ndotësve i shtohet nivelit të dobët të të ushqyerit, të papunësisë, të stresit social e familjar.

Studimet dhe publikimet e rolit të rrezatimeve mbi sëmundjet somatike dhe atyre gjenetike, edhe pse kanë karakter stokastik jo determinist, janë të shumta, të cilat kanë prirje të japin një korrelacion të fortë midis dozës së rrezatimit dhe shfaqjes së sëmundjeve të rrezikshme, si: leucemitë dhe kancerat. Sëmundjet kancerogjene ende konsiderohen multifaktoriale, por rrezatimet kanë koeficient të lartë në këtë polinom. Sipas ekspertëve, të cilët kanë ndjekur rezultatet laboratorike me kavje dhe epidemiologjistët me studime statistikore, nxjerrin se shfaqja e leucemive bëhet në një kohë të shkurtër, ndërsa kancerat për një kohë më të gjatë.

Mbi dozën 100 mSv, sëmundjet e kancerit janë të shumta dhe për çdo 5 mSv sëmundjet rriten gati 10%. Pra, kemi një varësi proporcionale nga doza e rrezatimit. Për doza 10-100 mSv sistemet e rinisjes së ADN janë aktive. Rinisja lejon mbijetesën e qelizave, por fillojnë të shfaqen gabime. Numri i rinisjeve gabim të ADN mutagjene është



i vogël, por i rëndësishëm, sepse kanë varësi me sasinë e dozës dhe debitit të saj. Studimet mbi efektin shkatërrues që shkaktojnë rrezatimet e ADN-së tregojnë se këto janë të njëjta me shkatërrimet që pësojnë spontanisht qelizat. Shkatërrimi spontan i qelizave i bindet ligjeve fiziologjike të rastit, ndërsa ai i shkaktuar nga rrezatimi, kryesisht është i përqëndruar, i drejtuar dhe shpesh i lokalizuar.

## Vlerësime statistikore

### A. Model matematikor mbi ekspozimin suksesiv dhe efektet

Efektet sanitare në varësi nga dozat e pësuar gjatë një viti mund t'i përgjigjen një funksioni polinomial (Zanobetti et al. , 2000 ; Schwartz, 2000 ; Roberts, 2005). Këto llogaritje duhet të futen njëkohësisht në model vlerat e ndotësve me diferenca të ndryshme kohore. Në këto raste, modeli do të tregojë korrelacione të ndryshme nga ato të nxjerra direct. Efektet e shfaqura në sfazim kohor përbëjnë shmangie të koeficienteve të korrelacioneve sipas ditëve suksesive

$$y_t = a + b_0x_t + b_1x_{t-1} + \dots + b_{q-1}x_{t-q} + \epsilon_t$$

ku  $y_t$  paraqet numrin e ndodhjeve sanitare ditën  $t$ ,  $x_t$  paraqet nivelin e ndotjes në atë ditë,  $x_{t-1}$  nivelin e ndotjes një ditë më parë, ...,  $x_{t-q}$  niveli i ndotjes në ditën  $t-q$ .

Modeli do të jetë i mundur të aplikohet nëse do të pranohet akumulimi kohor.

### B. Lidhja dozë efektive-vdekshmëri


Nisur nga përafrimet statistikore, do të pranojmë efektet ekuiprobabël të çdo lloji rrezatimi, mjafton që dozat të shprehen si doza efektive. Gjithsesi, në këtë material pranojmë gjykime statistikore dhe modelin Monte Carlo, pavarësisht nga nivelet e dozave, nga debiti i tyre, nga koha e ekspozimit dhe organeve njerëzore të ekspozuara. Për një gjykim mbi numrin e vdekjeve në varësi nga doza dhe nga numri i të ekspozuarve do të përdorim formulën:  
 $V = C \times E \times P^2$

Ku  $C = 0.05/\text{Sievert E- doza efektive}$

$P$ - popullsia e atij vendi të ekspozuar me të njëjtën dozë. Formula nuk merr parasysh karakteristikat individuale të lidhura me grupmoshat, me gjininë, me kushte e ndryshme të jetesës së individve të ekspozuar.

### Matjet dhe vlerësimet

Matjet e rrezatimeve mjedisore mjekësore elektromagnetike dhe atyre kozmike u kryen me aparatit Aier Counter-S model Japonez.



Aparati Counter Air-S, në dukje një aparat i thjeshtë, është i ndërtuar në Japoni menjëherë pas shpërthimit të reaktorit të Fukushima dhe është përdorur me kujdes sipas udhëzimeve prej marsit të vitit 2012.

Metoda e përdorimit është e thjeshtë: aparatit mbahet gati 1 m nga toka dhe ndizet pas 35 sekondash dhe bëhet leximi. Leximi përsëritet disa herë në çdo 10 sekonda. Kështu merret vlerësimi i rrezatimit gama. Për çdo rimatje shtypet butoni i rinisjes.

Të dhënat teknike jepen më poshtë.

Shtirirja e matjeve nga 0, 05 në 9, 99 mSv/orë.

Precizioni +/- 20%

Koha e matjeve max 2min, afishimi çdo 10 sekonda.

### Matjet e $Rn^{222}$

Matjet e  $Rn^{222}$  u kryen si matje pasive për një periudhë 3-mujore në sezone të ndryshme gjatë vitit shkollor.



Matje pasive të radonit me dedektor CR-39

### Përlllogaritja e vdekshmërisë së shkaktuar nga radoni nëpër shkollat e qytetit.

Pranohet në literaturë se rrezatimi alfa i radonit, për nga energjia në aktivitetin e tij me vlerë  $1000 \text{ Bq}/(\text{m}^3\cdot\text{an})$ , shkakton një dozë efektive të rendit 200 mSv. Lidhja e mësipërme mes aktivitetit dhe dozës efektive u përdor për llogaritje.

Ambientet tona shkollore të dedektuara me dedektor pasiv, me periudhë vendosje në mjedis për 3 muaj, dhe një mesatare që e kalonte  $150 \text{ Bq}/\text{m}^3$  për 3 muaj. Pra, nëse do të ishte e njëjta vlerë për të gjithë vitin, rrezatimi do të shkonte në  $600 \text{ Bq}/\text{m}^3$  në vit. Nëse temperaturat dhe mjediset do të ndryshonin pak ose aspak nga



kushtet tona të vlerësimit tremujor dhe fëmijët do të ekspozoheshin 10 muaj e 6 orë në ditë, doza efektive do të shkonte 25 mSv në vit.

Ky nivel i llogaritjes, sipas formulës 2 për një popullsi prej 10000 fëmijësh nëpër shkollat e monitoruara, do të shkaktojë një prekje nga kanceri i mushkërive  $V = 12.5$ . Por premise për t'u prekur nga kanceri mund të ndodh edhe pas 20 vjetësh. Konstatime më të detajuara në vite tregojnë se rrezatimi alfa i Rn dhe i pasardhësve të tij të futur në organizëm, mund të japin kancer në laring dhe në stomak.

### Një vlerësim i vdekjeve vjetore nga kancerat e llojeve të ndryshëm

Për llogaritjet vjetore jemi nisur nga vlerësimet dhe matjet që u kemi bërë gjithë dozave të rrezatimit.

1. Rrezatimi natyral  $0.05 \mu\text{Sv/h}$  për popullsinë 2 milionëshe të Shqipërisë vdekshmëria do rezultojë 43.2 vdekje në vit. Ky rrezatim përbën afërsisht fonin natyral.

2. Mbulimi piramidial i antenave të operatorëve më të përdorshëm për gjithë republikën shkakton një rritje 4-5 herë mbi vlerën e rrezatimit të fonit natyral. Pra, numri i vdekjeve shkakuar nga ky rrezatim do të jetë jo më pak se 200 në vit.

3. Diagnostikimi dhe skanerat mbi 20% të numrit të popullsisë së diagnostikuar shtojnë deri në 200 numrin e të vdekurve duke e pranuar rrezatimin në nivelin vjetor  $0.010 \text{ Sv}$ .

4. Rrezatimet e tjera, si: aksidentale, të ushqimeve, të ujit, të fluturimeve ajrore, shtojnë një rrezatim  $0.0002 \text{ Sv}$  mbi 40% të popullsisë shqiptare. Pra, kemi një shtesë në vdekshmëri 80 persona.

5. Përdorimi i së njëjtës formulë për rastin e rrezatimeve të Rn222 dhe të rrezatimeve të Po e të Ra të duhanit, do të kishte një shtesë jo më pak se 300 persona.

Totali i vdekshmërisë nga rrezatimet dhe pasojat do të jetë jo më pak se 823 vdekje vjetore.

Shtrohet pyetja se a ka regjistrime kur ato do të jenë të studiuara dhe të ndjekura me rigorozitet e të shoqëruara me të dhëna të rrezatimeve radioaktive të integruara për disa vite rresht? Mendoj se situata është dhe më e rëndë se kaq.

### Referenca bibliografike

R. Granier et D-J. Gambini Radiobiologie & Radioprotection appliqués

H. de Choudens et G. Troesch Introduction à la radioprotection

Emmanuel Grenier (Source : Fusion n°77, 1999)  
Faibles doses de radioactivité : une révolution dans la radioprotection

Këtu nuk është marrë parasysh në llogaritje efekti i rrezatimit të brendshëm shkakuar nga **C14 K40**. Ky rrezatim është i përhershëm dhe përbën gati 8.2% të rrezatimit total. Gjithashtu, nuk kemi përmendur rrezatimet ultraviolette që pësojnë të ekspozuarit në plazhet tona.

### Rekomandime

Rreziqet e kancerit u atribuohen dhe dozave më të ulëta se ato me të cilat ngarkohet njeriu gjatë një viti. Këshillat më rigorozet dhe më të mundshme për të përmirësuar shkakllën e rrezatimit janë:

-Së pari, kontrolli i vazhdueshëm i banesave, sidomos atyre përdhese, të vjetra e të ngritura në formacione granitike,

Së dyti, vlerësimi i dozave të absorbimit dhe i dozave efektive vjetore për çdo pacient, operator diagnostikimi dhe mjeku që ka në përdorim burime radioaktive.

-Angazhimi i ekipeve të mjekëve nën drejtimin e fizikanëve.

-Kontrolli i rrezatimit të antenave dhe kufizimi i përdorimit të celularëve.

-Duhanin duhet ta shohim si të rrezikshëm dhe për shkak të përmbajtjes së Po dhe Rn.

Siç shihet, radoni zë përqindjen më të lartë të rrezatimit vjetor prandaj është e arsyeshme që të llogaritet influenca e tij mbi sëmundshmërinë dhe pasojat vdekjeprurëse të tij.

Si përfundim, në këtë studim mund të pranojmë aplikimin e modelit Monte Carlo. Ky model për kondita dhe vlera të njëjta parametrash duhet të japë përfundime ekuiprobabël. Faktorët për rritjen e sëmundjeve kancerogjene janë të shumta.

Ndotësit radioaktiv janë ndër më kryesorët dhe në ngulim këmbë të përdoren për llogaritje dhe për vlera të ulëta të dozave efektive.

Për të gjithë banorët e komunitetit, sidomos për pacientët, duhet të ketë një vlerësim integral të radioaktivitetit vjetor. Monitorimi i rrezatimeve duhet të jetë detyrë e rreptë për operatorët, pacientët dhe mjekët.

UNSCEAR: Sources and effects of ionizing radiation, Report to the general assembly with annexes, United Nations 2000.

Zanobetti et al. , 2000 ; Schwartz, 2000 ; Roberts, 2005 Using Moving Total Mortality Counts to Obtain Improved Estimates for the Effect of Air Pollution on Mortality



## Pa universitete cilësore nuk ka të ardhme të shoqërisë moderne

Prof. As. Dr. Jorgo Mandili

### Abstract

In this thesis it is argued the correlation thesis between the changes of the digital society and the adaptation with an education system which appropriately responds these changes. This thesis requires specifically answer the following questions: What is the mission of the university? What is its relationship with society? How can the university realize its mission?

Through analysis, synthesis, examples arguments conclude that without quality universities there are not independent creative personalities and without the latter has no future of modern society.

The recognition of this dialectic relationship is the initial basic precondition for improvement, renovation and dimensioning of all problematic related to the education of creative personalities in Universities. This is fully consistent with contemporary new perspectives, conceptual, scientific and social development of society.

### Hyrje

Këtu do të paraqes një sërë pohimesh, jo të gjithëve do tu pelqejnë. Unë nuk jam nisur nga fakti nëse diçka pëlqehet apo jo, por nga fakti nëse ajo i korrespondon të vërtetës, qoftë kjo edhe e hidhur. E vërteta sado e hidhur qoftë, ajo është më e ëmbël se ëmbëlsira e gënjeshtër apo mashtrimit, është më pozitive se ka në thelb lirinë e shprehjes. Jam përpjekur të parashtoj në mënyrën më të mire që kam mundur, me ato aftësi argumentuese kam treguar kujdes vetëm për të vërtetën. Besoj se edhe ju ose të paktën shumica juaj angazhoni energjitë tuaja për të thënë të vërtetën. Edhe unë gjendem në të njëjtën pozitë me ju. Një gjë e tillë më vë në një pozitë të veçantë dhe e kuptoj se sa të vështirë e kam përballë një auditori të tillë.

Të kuptohemi: Ajo që unë do të parashtoj më poshtë duhet konsideruar vetëm si një mënyrë të menduari apo të konceptuari nga ana ime. Nuk pretendoj aspak ezaurimin shterueshëm të problemit në fjalë, i njohur prej shumicës tuaj lidhur me rolin e universiteteve si institucione në funksion të zhvillimit të shoqërisë për përgatitjen e atyre produkteve humane të aftë për përshtatje maksimale ndaj ndryshimeve të shpejta që ndodhin në shoqërinë e sotme digjitale.

Duke qenë një vend i vogël dhe me potenciale jo shumë të mëdha, këto ndryshime e vënë arsimin përballë të

tilla sfidave që jo vetëm ti përgjigjet në mënyrë adekuate këtyre ndryshimeve, por edhe të rifitojë kohën e humbur gjatë këtij tranzicioni të stërgjatë. E kjo kërkon një energji të barabartë me masën herë dijen në katror dhe jo çdo dije, por dijet e kuptuara si energji, si aftësi për të kryer punë, si kapital mendor për të bërë gjërat. Ky është sot misioni historik i arsimit, i cili fatkeqësisht nuk po orientohet dot me qasjet e reja të arsimit në botë. Një prej këtyre qasjeve të reja është ai që një arsim cilësor duhet të përgatisë individin që të përshtatet me tregjet e punës, tipografia e të cilëve do të ndryshojë shumë shpejt. Një qasje e dytë është ajo që një arsim cilësor i brezave rrit kohezionin shoqëror të garantojë ruajtjen dhe përcimin e vlerave kombëtare si dhe të rritë ndërveprimin midis vetes dhe botës së jashtme, të aftësojë individët për të përmbushur qëllimet për jetën. Një qasje tjetër është që një sistem arsimor cilësor duhet të zhvillojë ndjenjat e qytetarisë dhe përgjegjshmërisë shoqërore dhe të kontribuojë në konsolidimin e institucioneve publike dhe proceseve të politikbërjes. Në këtë kontekst edhe koncepti i universitetit rrjedh nga një përballje, nga një referim ndaj shoqërisë, po aq sa edhe në raport me produktet humane që e ushqejnë këtë shoqëri dhe, për këtë arsye gjenden në një raport reciprok me njëri -tjetrin. Misioni i universitetit si i tillë është i konceptueshëm vetëm në rrethin e shoqërisë e kështu zgjidhja e çështjes rreth destinacionit të tij presupozon zgjidhjen e një tjetër çështje: më saktë të asaj se cili është destinacioni i produkteve humane në shoqëri. Përgjigja ndaj kësaj pyetje presupozon nga ana e saj nevojën për t'ju përgjigjur një çështjeje edhe më parësore, asaj se cili duhet të jetë modeli i individit që duhet të përgatitet në universitet dhe cili është destinacioni i tij?

Përgjigjen e jep Odil Kuintin- (drejtores e përgjithshme për arsimin dhe kurrikulën në Komisionin Europian në vitin 2009) "Nëse duam t'i përgatisim të rinjtë që mund të përshtaten me ndryshimin dhe të punojnë në punë që nuk kanë ekzistuar ndonjëherë, **ne duhet ta rimendojmë arsimin jo mbi dijet, por mbi kompetencat.** Një optikë e tillë përbën thelbin e kuptimit të ri të dijes e cila çoi në çrrënjosjen e një dogme shumëshekullore dhe fillimin e mbarë të një konceptimi modern të arsimit që ka në themel të tij zhvillimet madhështore të shkencës dhe teknologjisë duke vënë edhe "kufirin" një kurrikule tradicionale 2500 vjeçare të Platonit dhe i hapi rrugën



një kurrikule të re, moderne, të shekullit të 21-të, gurthemeli i së cilës nuk janë tashmë dijet akademike, por kompetencat (akademike dhe metodologjike) e cila synon të përgatisë *individin e së nesërme, i aftë të përdorë dijet si investim intelektual për inovacione, për të vendosur elementet në një mënyrë të re, ndryshe nga më parë, që tu shtohet vlera*. Përvoja botërore në arsim e 50 viteve të fundit, studimet dhe eksperimentimet e bëra nga grupe shkencëtarësh, didaktësh, profesorësh, akademikësh të të gjitha fushave kanë evidentuar se parakushte themelore për të arritur suksesin janë:

1-Njohja e korrelacionit mes ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta të shoqërisë, shkencës e teknologjisë dhe arsimit, i cili duhet t'i përgjigjet këtyre ndryshimeve në mënyrë adekuate.

2-Njohja e lidhjeve të brendshme mes formimit cilësor të personaliteteve krijues pa të cilët nuk ka progres të shoqërisë dhe shëndetit shpirtëror të shoqërisë, pa të cilin nuk ka zhvillim të personalitetit të individit:

Jashtë këtyre lidhjeve, varësive dhe ndikimeve të ndërsjellta të mësipërme nuk ka patur dhe nuk mund të ketë ecje përpara, zhvillime, ndryshime e shndërrime të reja, rrënjësore e thelbësore, sasiore e cilësore, të vazhdueshme për përgatitjen e individëve krijues e të pavarur.

### **Pa ushqimin shpirtëror të shoqërisë nuk ka individë krijues dhe pa këta të fundit nuk ka shoqëri moderne.**

Gjithçka që realizohet në një shoqëri bëhet me arsye dhe me vullnet nga individët. Nuk ka zhvillim e progres të shoqërisë pa individët krijues që të mendojnë në mënyrë të pavarur –thekson Ajnshtajni. Pse? Sepse njerëzit krijues janë personalitete të pavarura, janë të prirur të marrin përsipër rreziqe janë të pashtershëm në ide, energji e vullnet për të krijuar modele të reja duke luftuar për realizimin e tyre në jetë. Vetëm individit krijues mund të krijojë vlera të reja për shoqërinë, për më tepër madje edhe të përcaktojë standarte të reja morali në shoqëri. Ne nuk e dimë të ardhmen e shoqërisë as të shkencës por jemi të bindur se nuk ka zhvillim e progres të shoqërisë moderne pa të ardhme të universiteteve ku përgatiten individët krijues. Kjo është një lidhje e brendshme thelbësore dhe objektive, shfaqja konkrete e së cilës është cilësia e produkteve humane që furnizojnë vazhdimisht shoqërinë, por nga ana tjetër cilësia e këtyre produkteve humane është e pamendueshme pa ushqimin shpirtëror të shoqërisë. Këtë raport, përveç Ajnshtajnit nuk mund ta shprehte në mënyrë shterues asnjë tjetër. Pa personalitete krijuese të afta që të mendojnë dhe të gjykojnë në mënyrë të pavarur, zhvillimi dhe përparimi i shoqërisë është aq i pamendueshëm sa dhe zhvillimi i personalitetit tek individët pa ushqimin shpirtëror të shoqërisë.

Mendja dhe shpirti i një shoqërie moderne, sipas Shekspir, janë Arsimi dhe Morali. Asnjë organizëm nuk mund të quhet i shëndetshëm, në qoftë se ka defekte në mendje dhe deformime në shpirt. Kështu ndodh edhe me shoqërinë, defektet në arsim dhe deformimet në moral e çojnë një shoqëri në krizë institucionale,

financiare, administrative, por mbi të gjitha morale. Kriza në shoqërinë tonë anon më së tepërmi nga imoraliteti, ku gënjeshtria, padrejtësia, abuzivizmi, mashtrimi, zhvatja, vjedhja, hipokrazia, zilitë meskine, intrigat, tribalizmi, nepotizmi, korrupsioni etj, janë shndërruar në sistem jete, janë kthyer në virtyte, kanë fituar qytetarinë duke u shfaqur në pamje e forma të ndryshme me lloj-lloj "çmendurish e marifetesh". Ja si e përshkruan shoqërinë tonë, një gazetari i "New York Times":

"Ekziston një vend në Ballkan i cili kufizohet me vetveten. Ku jetojnë gratë më të bukura dhe lindshmëria është në rënie. Ku të papunët më së shumti punojnë. Ku të gjithë nxitojnë për në punë, dhe askush nuk arrin në kohë. Aty ku tetë-orëshi i punës zgjat 12 orë. Aty ku shëndetësia është pa pagesë ndërsa shërimi i shtrenjtë. Ku gazetarët janë të lirë të shkruajnë çdo gjë që ju urdhërohet. Ku sekretet shtetërore janë publike. Aty ku historia përsëritet çdo ditë. Ku më të pasurit janë njerëzit të cilët kurrë nuk kanë punuar. Aty ku përdorët valuta e huaj. Aty ku të mençurit i deklarojnë të çmendur, dhe të çmendurit të aftë. Aty ku analfabetët e shkruajnë historinë. Aty ku ligjet janë të paligjshme, ndërsa anarkia gjendje normale. Aty ku jetohej për të ardhmen sepse për të tashmen nuk kemi të drejtë. Aty ku çdokush e përqesh tjetrin dhe askush askujt nuk ia dëshiron të mirën. Aty ku proceset gjyqësore zgjasin më shumë se jeta. Ku përmytjet janë e vetmja mënyrë për ujitje. Ku konsiderojnë se vendi do të përparojë më shumë nëse xhiron gjithnjë e më tepër. Ku normalët nuk janë të nevojshëm, dhe punësohen të pa përshtatshmit e jo të aftët. Aty ku statistikisht është populli më i shkolluar, por më i padituri. Ku ka akademikë pa vepra shkencore, profesorë pa monografi shkencore, pedagogë pa asnjë qasje me mësimdhënies dhe akademizmin, me grada e tituj të dhuruar jo të fituar. "Shkencëtarë me integritet copë -copë, që gënjejnë për kërkimin shkencor, që manipulojnë të dhëna, analiza, raporte duke shpikur madje për herë të parë një nga trafiqet më të çuditshëm, trafikun e kërkimit shkencor. Është në Ballkan një vend ku me ndershmëri, sinqeritet dhe zell kurrë nuk do të arrish qëllimin e dëshiruar ... " Kjo tablo e trishtë është degjenerimi ynë, është prishja e ADN-së së një kombi, është fatkeqësia e një populli që është goditur pikërisht në thelbin e ekzistencës së tij; tek arsimit dhe morali, gjë që çoi në kaosin e madh të degradimit të shoqërisë duke përfshirë dhe universitetet drejt një "kolapsi fundosjeje, një dramë Titaniku-do ta përcaktonte Prof. B. Gjonecaj dhe jo pa qëllim, në qoftë se kujtojmë fjalët e Lordit Braaugham: "Arsimi e bën një popull të lehtë për ta udhëhequr, por të vështirë për ta sunduar, të lehtë për ta qeverisur, por të pamundur për ta skllavëruar e kuptojmë se pse sundimi dhe skllavërimi ky ka qenë lajtmotivi i të gjithë politikanëve dhe të gjitha qeverive si të majta dhe të djathta gjatë këtyre 23 viteve, se ndryshe nuk ka se si të shpjegohet rrënimi total i arsimit dhe moralit në vendin tonë deri në atë "derenxe" sa që nga dyert e universiteteve tona të dalin "sharlatanë e diplomë" dhe "servilë të regjimit, që u mjafton vetëm shtylla kurrizore"- do të theksonte Ajnshtajni. U krijuar shteti i diplomave në tre ciklet e studimi: bachelor, master e doktoratë dhe kjo për dy arsye themelore, midis shumë të tjerave.





Së pari, nga politikat tallëse apo miope, jo serioze apo të papërgjegjshme të të gjitha qeverive pas viteve '90 për reformat në arsim, për hapjen e universiteteve, për standartet e diplomave etj.

Së dyti, nga relativizimi i të vërtetave mbi arsimin të bëra nga radha e opinionistëve, masmedia, nga njëra anë, dhe nga intelektualët gjoja të pavarur, profesorët e akademikët peticionistë, nga ana tjetër. Filozofia e tyre ka qenë dhe mbetet ende fatkeqësisht –filozofia mashtruese "rrobave të reja të mbretit".

Relativizimin e së vërtetës, –Karl Popper, e ka cilësuar si një nga parimet më të shëmtuara të "intelektualëve", tradhëti ndaj arsyes e shoqërisë me tautologji dhe banalitete të lezetuara me marrëzi paradoksale e fjalë bombastike që nënkuptohen me vështirësi". Të dy palët, si këta të fundit edhe ata të parët (politikanët dhe qeveritarët )me qëndrime të tilla të "papërgjegjshme" kanë bërë atë që as armiku më i madh i Shqipërisë zor se do të arrinte kaq suksese në këtë ndërmarje makabre ndaj arsimit të lartë: zhbërjen e tij totale.

Si u realizua kjo zhbërje? Cilat ishin mjetet që përdorën kjo radhë politikanësh, analistësh e akademikësh?

#### 1. Masivizmit.

Mbipopullimi i universiteteve në të tre ciklet e studimit solli degjenerimin moral të studentëve dhe pedagogëve, certifikim të paaftësisë me blerje diplomash, titujsh e gradash në përfitues postesh, në produkte humane pa profil publik "të shkolluar të paditur"që krijuan "ajkën e politikës dhe qeverisjes" duke i lënë këtij populli në "derë" një kaos total në arsim, drejtësi, mjekësi, administratë të kombinuar me një korrupsion të frikshëm në çdo lloj marrëdhënieje. Mbipopullimi në të tre ciklet ishte shkatërrues sepse goditi moralin e universiteteve, çka shkaktoi kaosin e madh: degjenerim të menjëhershëm të tyre duke i kthyer ato nga "tempuj të dijes e kulturës" në "tempuj të marrëzisë e mafies universitare".

#### 2. Abuzivizmit.

Nga rritja e shpejtë e numrit të studentëve u krijua vështirësi si për stafin akademik ashtu edhe për mjedisin e bazë mësimore që degjeneroi cilësinë e mësimdhënies e punës kërkimore duke kultivuar abuzivizmin masiv të stafit akademiko-shkencor universitar në gradat e titujt akademikë. Ky proces i detyroi shumicën e atyre militantëve të rekrutuar rastësisht në universitet pa asnjë qasje me akademizmin, kërkimin apo mësimdhënien disa herë me integritet copë-copë, të gënjejnë për kërkimin shkencor që bëjnë, të manipulojnë të dhëna, analiza, raporte duke shpikur madje për herë të parë një nga trafiket më të çuditshme, trafikun e kërkimit shkencor. Shumica e këtyre "të ngratëve filluan ta bëjnë të tyren punën shkencore të tjetrit, të paguajnë për të vënë emrin e tyre në një punë shkencore, vetëm e vetëm që të plotësohen kriteret e formularit të përcaktuar nga VKM-ja. Kështu krahas "renzobosëve" të ciklit të parë dhe të dytë universitar lindën OMGJ-të antropomorfe të ciklit të tretë: "doktorët e shkencave " dhe "Profesorët" me plagjaturë. Kjo radhë –"shkencëtarësh" e "profesorësh" e vetmja gjë që bën mirë është prodhimi i mediokritetit dhe servilizmit si mënyrë sjelljeje për të bërë karrierë. Pra vetë

sistemi i kualifikimit shtetëror me VKM i detyron njerëzit të abuzojnë duke blerë të gjitha pengesat që u dalin përpara dhe një ditë të bukur këta "horra" akademikë i sheh në rastin më të keq lidhshpa në universitet dhe në rastin më të mirë parlamentarë.

#### 3. Korrupsionit.

Një simptomë tjetër e shëmtuar e humbjes së dinjitetit moral të pedagogut. Të ushtrosh "profesionin" e mitmarrjes dhe atë të pedagogut njëkohësisht do të thotë të shkelësh mbi karakterin tënd, mbi misionin tënd, mbi ndërgjegjen tënde, do të thotë të shesësh moralin e kulturën tënde. Korrupsioni në arsim ka "krimbur" shoqërinë tonë duke nxjerrë breza e individë të pamoralshëm e të padobishëm për ti shërbyer shoqërisë me devotshmëri e përkushtim për zhvillimin e saj. Ky lloj korrupsioni është i vështirë për tu luftuar, por i lehtë për tu evidentuar. Ja se çfarë shkruan një studente e një universiteti rajonal:

"Për fat të keq, dua të bëj një denoncim ndaj atyre "pedagogëve" që dalin para auditorëve, pa qenë të aftë profesionalisht e shkencërisht, pavarësisht se kanë grada dhe tituj akademikë, si dhe ndaj autoriteteve drejtuese që lejojnë një turp të tillë dhe akoma më keq që pedagogë të tillë përhapin opinione tek studentët se lënda që ata japin është "shumë e vështirë" dhe, pa një "ndihmesë" (nënkupton pagesë) vështirë të merren vlerësime pozitive në provime. Këta pedagogë me ndërgjegje marrin përsipër paturpësinë morale përballë studentëve në auditor dhe opinionit publik, të japin vlerësime të pamerituara për studentët duke shkëlur të gjitha rregullat e etikës universitare dhe ligjore. Unë nuk e di nëse duhet ta pranoh një gjë të tillë, që këta pedagogë të paaftë të firmosin diplomën time dhe më vjen keq, madje ndjej një mëshirë të thellë për veten dhe të gjithë studentët që ulen nëpër auditore, ambiciozë dhe plot ëndrra për të ardhmen. Të dashur student. Respektoni veten tuaj, që nesër t'ju respektojnë edhe nderojnë të tjerët juve, -përfundon mesazhin kjo studente.

#### 4. Lidhshpit akademik.

Zgjedhjet nxjerrin në krye jo domosdoshmërisht më të diturit, më të aftët, më komunikuesit, por më të "shkathtët", më premtuesit e më demagogët. Zgjedhjet universitare pra janë një farsë. Lidhshpi ekzistues universitar nuk është gjë tjetër veçse "jashtëqitje" e politikës dhe e klaneve të caktuara, i maskuar me "zgjedhje demokratike" në një demokraci jo funksionale ku as zgjedhjet politike nuk janë demokratike.

Zgjedhjet universitare, jo vetëm që e kanë humbur rolin e tyre në nxjerrjen e autoriteteve të vërteta universitare, por për shkak të deformimit të misionit dhe rrënimin të integritetit të vetë institucioneve, janë kthyer në faktorin më esencial, të prapambetjes universitare, të riciklimit të të paaftëve dhe të njerëzve që nuk kanë asnjë qasje as me misionin e universitetit, as me idealin e akademizmit, e as me përkushtimin ndaj mësimdhënies, por vetëm qasje klanore të ruajtjes së pushtetit. Pikërisht ky lidhshpi anonim i ka dhënë "dorën e fundit" rrënimin universitar duke e transformuar atë në një sistem universitar të atrofizuar, në gjëndje "reanimacioni", që i mungon konkurrenca e brendshme, që komandohet nga



politika ku "soji e sorollopi i saj është futur deri në mitrën e universiteteve dhe kënaq" epshe nga më poshtëruese. -Kjo tablo e zymtë e universiteteve është "vepra" jonë e këtyre 23 vjetëve, e formësuar nga politika e qeveritë dhe e mbështetur nga arradha e opinionistëve duke shkelur çdo standard, jo vetëm ligjor, jo vetëm material por mbi të gjitha moral pa marrë parasysh përgjegjësinë historike për dëmin e madh që i kanë shkaktuar shoqërisë sonë deri në atë shkallë sa është vënë në rrezik real jo vetëm dinjiteti ynë kombëtar, por edhe vetë ekzistenca e sistemit tonë universitar. Këtë "njollë murtaje" i lanë dhuratë qeveritë demokratike, akademikët e profesoret shoqërisë sonë nëpërmjet reformave "haxhiqamiliste" që çuan drejt kaosit e anarshive. Zhgënjimi dhe vetmashtimi duhet të marrin fund sepse e vuajnë vetë studentët, sidomos ata që janë diplomuar. Ja si i përgjigjet një student i shkëlqyer i mjekësisë pyetjes së një gazetari të "shekullit" se si ndihej pas përfundimit të studimeve universitare.

" Zhgënjimi" tashmë pas pesë vitesh studimi është shumë i madh. Kjo për shkak të problemeve të pafundme akademike dhe infrastrukture me të cilat ky universitet përballlet. Nuk e kisha menduar kurrë që në universitet, studentët edhe në fund të vitit të pestë, pyeten si në klasë të parë. Duhet një reformë e thellë, e cila ti japë fund kësaj plage sociale, që sa vjen e thellohet më shumë. Na duhen universitete që ti japin liri mendimit shkencor dhe jo universitete si ky yni, që prodhon sharlatanë me diploma, jo profesionistë të aftë " përfundon studentit. Në këtë kontekst, sfida që qëndron para universitetit është : Do të "prodhojë" qytetarë të formuar me normat dhe standardet e demokracisë së të drejtës, të cilët e konsiderojnë shërbimin e tyre për shoqërinë si problem madhor të jetës së tyre apo "sharlatanë me diplomë", "servilë të regjimit", individë standardë pa origjinalitet dhe pa identitet që "trurin e kanë të tepërt, u mjafton vetëm shtylla kurriore, turma që ndjekin verbërisht të parin e tyre? Përgjigja e kësaj pyetjeje presupozon nga ana e saj nevojën për t'ju përgjigjur një çështje tjetër: si mundet universiteti të transformohet në një institucion i cili të emetojë produkte humane që ta shëndoshin shoqërinë? Përgjigja e kësaj pyetjeje na orienton drejt një pyetjeje tjetër: a duhet rishikuar koncepti universitet? A mund të edukohen si tani kaq shumë njerëz? A është e mundur të garantojmë cilësinë? A ka profesione që për arsye të theksimit praktik , thelbësor nuk meritojnë studime universitare? Paul Gubbins- profesor universiteti në Britani, mendon se ka ardhur koha për ta riekzaminuar konceptin universitet dhe pyet: a mund të quajmë universitet një institut nëse në degët e tij nuk përfshihen p. sh. fizika, filozofia apo gjuhët e huaja moderne? Çfarë është pra një universitet sot?

Në një reportazh me titull "Udhëtim në vendin e Timoniervë" botuar tek "Shqiptarja. com" gjatë vizitës së tij në Republikën Popullore të Kinës, gazetari i mirënjohur Ilir Babaramo tregon se pyetjes që i bëri shoqëruesit të tij se: "Kur do ta fitojë Kina garën që i ka hyrë me SHBA-në- ai u përgjigj : "Kur universiteti i Pekinit të jetë më i mirë se Universiteti i Harvardit. Mesazhi është i qartë. Nuk ka zhvillim, nuk ka progres të shoqërisë pa universitete cilësore. Ndikimi i universiteteve ka ardhur duke u rritur gjatë shekullit të fundit deri në atë pikë sa

është bërë një faktor vendimtar i progresit dhe zhvillimit të shoqërisë moderne. Sot po përpunohet një koncept e filozofi e re për rolin parësor që po luajnë dhe që duhet të luajnë universitetet në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të një vendi. Në lidhje me këtë "cilësia e universiteteve dhe e kërkimit shkencor konsiderohen të barabarta me efektet që japin teknologjitë moderne dhe format e avancuara të drejtimit dhe menaxhimit", gjë që çon domosdoshmërisht në transformimin e universitetit nga "tempull i dijeve, kulturës e formimit të përgjithshëm qytetar, në një institucion në funksion të zhvillimit, të përgatitjes të mendjeve cilësore duke i dhënë përparësi kreativitetit individual e kolektiv, me aftësi e shprehje intelektuale, për të zotëruar me efikasitet idetë dhe informacionin e akumuluar dhe për tu orientuar dhe vepruar në situata të reja problemore, për një përshtatshmëri maksimale në përballimin me sukses të tregjeve të punës apo profesioneve të reja të pamendueshme gjatë shek 21-të. Transformimet e sotme të shoqërisë, ekonomisë, shkencës dhe teknologjive si dhe evolucionin e dijeve i kanë futur universitetet në një përshtjellim rreth synimeve të tyre finale: kërkimi shkencor, trajnimi profesional apo përfshirje sociale? Nga debatet e zhvilluara rreth rolit të ardhshëm të universiteteve evropiane, nënkuptohet se sot asnjë nga këto synime nuk duket i sigurtë. Cili opsion është më i sigurtë? Sipas Viktor Prez-Diaz, (president i ASO Research Center në Madrid, anëtar i AAAS dhe E), universitetet si institucione shkencore që përipiqen të kapin ekselencën kërkimore të arritur nga universitetet më të mira amerikane, nuk shihet si opsion i mirëpritur, përderisa "kërkuesit shkencorë nuk janë më të kufizuar në kullat e tyre të fildishta", por punojnë si pjesë e rrjeteve komplekse globale, përkrah pjesëmarrësve nga sektori privat". Ndryshimet e mëdha transformuese në erën digjitale të shoqërisë kanë çuar në një qasje të re: në ngushtimin e atij kufiri të prerë midis shkencëtarëve akademike (që punonin vetëm apo në grupe të vogla për interes të tyre) dhe shkencëtarëve industrialë që punojnë në grupe të mëdha dhe projekte për qëllime komerciale), ngushtim i cili po çon drejt bashkimit të këtyre dy grupeve, drejt asaj që I. Ziman e quan shkenca "post akademike", ku puna shkencore tashmë zhvillohet me ekipe të mëdha (që rrjetëzojnë institucione dhe vende) dhe që përfshijnë projekte të një shkalle të gjerë, disiplina të ndryshme dhe përdorim metodash të larmishme". Në këtë kuptim është e vështirë që të gjitha universitetet ta shohin veten, kryesisht si institucione shkencore.

Një qasje tjetër është ajo që është përpunuar për rolin parësor që po luajnë e duhet të luajnë "universitetet në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, e social të një vendi. Në raport me këtë cilësia e universiteteve dhe e kërkimit shkencor, konsiderohen të barabartë me efektet që japin teknologjitë moderne dhe format e avancuara të drejtimit dhe menaxhimit . (Forumi për zhvillim të qëndrueshëm Evropë-Kinë- Sfidat e shek XXI, mbajtur me tetor 2008, Bruksel). Universitetet përtej misionit të tyre të prodhimit dhe të përhapjes së dijeve duken se po kthehen çdo ditë e më tepër në "aktorë influentë" të ekonomisë dhe evolucioneve sociale" dhe po shkojnë drejt një profili të ri shumë dimensional duke u nisur nga



parimi se "studimet dhe kërkimet universitare duhet të jenë në shërbim të ekonomisë dhe jo të kërkojnë që të mbështeten ekskluzivisht nga ekonomia dhe buxheti. Pra, vlera e dijeve që ato ofrojnë po matet edhe me efektet financiare që ato japin si për të diplomuarit ashtu edhe për vetë universitetet, ndërkohë që edhe vete "tregu akademik" po kërkohet të funksionojë sipas modeleve menaxheriale " indikatorëve të performancës dhe imazhit të markës". Nga ana tjetër edhe kërkimi shkencor po ri-orientohet çdo ditë e me tepër drejt "produkteve të matshme e ekonomisht rentabël dhe jo thjesht si zhvillim akademik"- thekson Prof. A. Civici. Megjithatë, aftësitë që kërkohen sot jashtë botës akademike, po ndryshojnë kaq shpejt sa që universitetet mund të dështojnë për të bërë bashkë "aftësitë gjenerike konjitive të mësuara në klasë, -si për shembull, të menduarit kritik, arsyetimi analitik, zgjidhja e problemave dhe të shkruarit-me ekspertizën profesionale që kërkohet gjithnjë e më shumë në vendet e punës- thekson Y. P. Diaz. Nëse vite e vite shkollimi nuk përkthehen në aftësi më të mëdha konjitive për të punësuar shpejt dhe për të shitur sa më shtrenjtë diplomën e vet në tregun e punës, atëherë kuptohet se do të bjerë interesi për të investuar në arsimin e lartë. Qasjet e mësipërme, asnjëherë nuk mund të realizohen shterueshëm. Më e pranueshme është një qasje e tretë "me synimin që priret nga tregu i punës e që e vë theksin të konkurrenca ndërmjet institucioneve inkurajon mobilitetin e stafit dhe studentëve, si dhe thekson mësimin që ka në qendër studentin. Kjo qasje na duket më afër me realitetin tonë shqiptar. Qasja e parë për ne është ende e paarrtshme sepse, së pari, në universitetet tona nuk ka një traditë të punës së mirëfilltë shkencore, shpesh kjo punë kerkimore, është realizuar ose si individ ose në çift, ose në grupe të vogla, por gjithmonë pa një finalitet të përcaktuar, biles, edhe brenda një departamenti, pa bërë fjalë për fakultet e më tej. Po të flasim për shkencat natyrore dhe aplikative, kjo qasje bëhet akoma më e pamundur. Po kështu edhe qasja e dytë, që synon profesionistë kompetentë sa mbaron universitetin, është jo realiste, për vetë arsyet e parashtruara më lart për aftësitë që kërkohen sot jashtë botës akademike që ndryshojnë kaq shpejt sa që universitetet mund të dështojnë në realizimin e tyre. Atëherë kuptohet që qasja më oportune është ajo e treta, e cila, thekson mësimin që ka në qendër studentin, vë theksin tek konkurrenca ndërmjet institucioneve e cila priret nga tregu i punës. E thënë më qartë: universitetet të kthehen në qendra debati, reference dhe ekspertize e që ofrojnë zgjidhje dhe alternativa që u shërbejnë nevojave të tregut. Një vizion i tillë domosdoshmërisht çon në konceptimin e rolit të universitetit, tashmë si institucion ku individët të kryejnë punë dhe veprimtari duke u mbështetur në dije, të fitojnë dije të reja për vlerësimin e ideve dhe informacionit të akumuluar nga vëzhgimi, leximi, përvoja dhe për t'i përdorur ato si një busull për orientim dhe veprim në situatë të reja akademike apo jetësore. Kjo do të thotë që ata të bëhen të aftë për një përshtatshmëri maksimale për të përballur me sukses tregjet e punës apo profesionet e reja të pritshme të shekullit të 21-të." Nëse një njëri zotëron shprehje të tilla theksonte Ajnshtajni me siguri që do ta gjejë rrugën e tij

dhe për më tepër do të jetë më i aftë për t'u përshtatur me përparimin dhe ndryshimin, në krahasim me një person tjetër, përgatitja e të cilit parimisht është e orientuar në akumulimim e dijeve dhe jo në përpunimin logjik të tyre". Pritshmëri të tilla varen nga:

- a) qëndrimi që do të mbahet ndaj kurrikulës në procesin e reformimit, dmth nga një filozofi kurrikulare e cila të garantojë edukimin e një individi në funksion të zhvillimit, një filozofi kurrikulare që do t' i japë kuptim vendimeve dhe veprimeve tona, një filozofi që ta udhëheqë këtë veprimtari drejt përsosjes së procesit arsimor. E tillë e qartë, duhet të jetë filozofia kurrikulare dhe jo një kurrikulë pa filozofi.
- b) Qëndrimi që do të mbahet ndaj standarteve të stafit akademik dhe lidhshimit të tyre. Staf apo lidhshim akademik pa identitet apo gjenetikisht të paaftë për tu vetëfaktorizuar si personalitete akademike aspak nuk garanton cilësi çfarëdo reforme të ndërmerret.
- c) Infrastruktura për të krijuar fasilitetet e nevojshme për një punë normale dhe si në të gjithë universitetet e botës.
- d) Baza materiale e praktika profesionale si domosdoshmëri e aftësimi praktik real të studentëve. Nuk do të të pyes njeri se sa diploma ke, por çfarë di të bësh: di të projektosh, matësh, eksperimentosh, sintetizosh, krahasosh, hulumtosh etj, etj.
- e) Kontigjentet si prurje fillestare të universiteteve, të cilët deri tani me kriterin Meritë-pameritës dhe preferencës selektive kanë ardhë analfabetë funksionalë gjë që nuk kanë siguruar jo vetëm rritje cilësie por i kanë kthyer universitetet në strehë të këtyre kontigjentëve të cilët deri tani vazhdojnë ende të furnizojnë shoqërinë shqiptare me "renzobosë" duke u bërë një faktor regresi për zhvillimin e saj.

Këta elementë thelbësorë pra përbëjnë edhe kornizën kushtetuese të një universiteti modern. Pa u ndalur në këta tre të fundit: infrastruktura, baza materiale e kontigjentet sepse përmirësimi i tyre është më tepër problem teknik, financiar e vullneti, sepse kushdo e di se në një korpus universitar janë padyshim fasilitetet më të mirëorganizuar për kulturën e qytetërimit e studentëve, bazë material - laboratorike e biblioteka universitare janë "dritaret" e aftësimi teoriko-praktik të studentëve si dhe pranimi i studentëve me mesatare të lartë dhe me provim hyrës në universitet ska dyshim se janë kondita të nevojshme për garantimin e produkteve humane cilësore, por jo të mjetueshme. Dy të parat janë vendimtare. Filozofia kurrikulare e cila projektton specialistin e ardhshëm, dhe stafi akademik i cili e zbaton këtë projekt dhe lidhshimi akademik që e drejton, udhëheq projektin për arritjen e suksesit. Prandaj le të ndalem pak më tepër tek këto dy elemente .

Ne nuk vuajme nga hartimi i kurrikulave të reja, të cilat i kemi "copy paste" nga më të mirat e universiteteve më të njohura në botë. Sa kuptohen e realizohen ato në praktikë? A shprehin ato filozofinë e kompetencave për ta aftësuar individin të bëjë gjëra, të kryejë veprimtari që i kupton dhe jo të detyrohet për veprime dhe qëndrime





me përmbajtje abstrakte, të pakonkretizuara të cilave nuk u di kuptimin.

Në kontekstin e argumentave të parashtuara më lart, kuptohet se çfarë përpjekjesh duhen bërë për të përkthyer idenë e arsimit akademik në terma operative (kompetenca) për kurrikulat në Bachelor dhe në Master me synim: aftësim i studentëve për t'i përdorur përmbajtjet lëndore dhe ato jetësore si burime për të ndërtuar kompetencat profesionale që e lejojnë studentin të integrojë sisteme konceptuale dhe procedurore me shkathtësinë dhe vlerat dhe të arrijë trajtimin e duhur të situatave problemore. Duhet të vendosen kritere të qarta shkencore, metodologjike e didaktike midis këtyre dy cikleve të studimit. Ku duhet të ndryshojnë midis tyre këto dy cikle studimi? Dallimi kryesor qëndron jo në faktin se Bachelori ka nivel më të ulët se Masteri. Jo! Shoqëria digjitale kërkon që edhe të parët të kenë kualifikimin të lartë, por si zbatues dhe ekzekutues të klazit të lartë, kurse të dytët duhet të përgatiten si organizatorë, udhëheqës, drejtues të fushave përkatëse të studimit, inisiatorë dhe përcjellës të mendimit tekniko-shkencor përkatës. Prej këtij vizioni rrjedh se aspekti më themelor dhe më delikat në kurrikulën e Bachelorit është përcaktimi i asaj kulture fundamentale "bërthamë" jo vetëm për formimin shkencor, por edhe aftësimin e tyre për rinovim të vazhdueshëm të dijeve të tij.

Ndërkaq kurrikula e Masterit duhet të përfaqësojë një stad më të lartë, më integruar, më të thelluar e më përgjithësues të dijeve si në aspektin shkencor, metodologjik, filozofik e didaktik që në fund të studimeve ai të arrijë statuse profesionale të nivelit të lartë, teorikisht të jetë i përgatitur mjaftueshëm për të bërë studime teorike e eksperimentale dhe t'i krijohet mundësia për një shkollë doktorature.

Po kaq i rëndësishëm është edhe rimodelimi i një didaktike universitare sipas parimit të Humboldt: "Arsimim nëpërmjet Shkencës". Në universitete tona sot mbizotëron një kaos i vërtetë në metodologjinë e mësimdhënies ku prevalon të mësuarit mekanik, vlerësim tradicional e subjektiv. Ka staticizëm dhe konservatorizëm. Metodologjia e mësimdhënies nuk është as Lindje as Perëndim.

Koncepti Humboldtian i harmonizimit të mësimin dhe kërkimit shkencor i konsoliduar prej dy shekujsh në universitetet perëndimore, sot është prezent edhe në universitetet e Evropës Lindore. Edhe në një studim bashkëkohor si ai i Prof. Altbach, (drejtor i "Qëndrës Ndërkombetare për Arsimin e Lartë e në Kolegjin e Bostonit), vlerësohet se për suksesin e çdo lloji ekonomie moderne është qëndror roli i institucioneve sipas modelit "mësim dhe kërkim shkencor". Me kushtin që të mos ketë "anarki, dembelizëm dhe mungesë hirearkie shkencore", por qeverisje e brendshme të vendosur në duart e profesorëve, meritokraci rigorozë, liri akademike, angazhim në shoqëri.

Arsimimi përmes shkencës do të thotë që nëpërmjet mësimdhënies të transmetohet mendimi shkencor, ku si bazë metodologjike e të menduarit do të shërbejë metoda shkencore.

Futja e kësaj metode në mesimdhënien universitare e bën të mësuarin me eficient dhe më efektiv dhe kryesorja

"kanalizon" llogjikën, vendos rregull në të menduarit, kultivon intelektin. Prandaj metoda shkencore duhet të bëhet derë e hapur në mësimdhënien universitare sepse gjatë studimit të shkencave, studentët fillojnë të zhvillojnë një të menduar e të mësuar të shkencës më të thellë e më intuitiv, duke u përqëndruar tek thelbësorja, duke injoruar jo thelbësoren. Shkurt: arsimimi nëpërmjet shkencës do të thotë transmetim idesh dhe informacion nëpërmjet metodës shkencore, e cila sipas F. Bekonit- u lejon njerëzve të zakonshëm të bëjnë gjëra të jashtëzakonshme, por sipas M. Veberit, arsimimi shkencor është aftësi e aristokracisë intelektuale, e ketë nuk duhet t'ia fshehim vetes. Mësimdhënia shkencore është një dhunti, është një prirje e brendshme, është një përjetim. Pa këtë përjetim, pa këtë pasion nuk mund të garantohet arsimimi shkencor. Sigurisht, pasioni është një kusht fillestar i faktorit "frymëzim", por jo vendimtar është edhe puna e vazhdueshme, kualifikimi i vazhdueshëm, kërkimi e hulumtimi i vazhdueshëm. Pra puna dhe pasioni, kërkimi e hulumtimi është detyra e parë e një profesori. Dalim kështu tek cilësia e stafit akademik.

Ekziston mendimi se mjafton të jesh shkencërisht i përgatitur dhe je mësimdhënës i mirë. Kjo pa dyshim është konditë e nevojshme, por jo e mjaftueshme. Mund të jesh dijetar i shquar thekson M. Veber, dhe pedagog tmerrësisht i keq. Nëse për një pedagog thuhet se ai është i keq kjo është për të në më të shumtën e rasteve dënim akademik me vdekje, qoftë ai dijetari i pari i botës... se ndoshta nga ana pedagogjike detyra më e vështirë nga të gjitha është paraqitja e problemeve shkencore në një mënyrë të atillë që një kokë e pashkolluar, por e aftë për të kuptuar dhe që për ne është më vendimtarja të arrijë që të mendojë në mënyrë të pavarur mbi ato probleme"- përfundon M. Veber. Pra jeta akademike universitare ka dy aspekte: mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Të dy këto aspekte janë parakushte themelore për të siguruar një "arsimim nëpërmjet shkencës" si gurthemeli i mësimdhënies universitare sipas Humboldt. Të qenurit pedagog do të thotë në rradhë të parë profesionalizëm, përkushtim, ambicje, kërkesë llogarie ndaj vetes dhe të tjerëve. Do të thotë të jesh dinjitoz, komunikues, të krijosh marrëdhënie institucionale e humane me studentët në shërbim të interesit reciprok e në harmoni për misionin për të cilin punojnë në interaktivitet midis tyre. Janë këto elemente të domosdoshëm të kulturës, shprehive dhe aftësive intelektuale të atij i cili "ndjen" se e ka prirjen dhe ndërgjegjen për ta parë profesionin e pedagogut si mision e si përkushtim të pastër ndaj çështjes, sepse problemi tek universitete tona nuk janë metrat katrorë, raporti pedagogë-studentë, syllabuset, etj, por niveli i ulët i stafit akademik për t'i zbatuar kurrikulat e reja. Kaq e thjeshtë dhe tragjike . Studime të mirëfillta për këtë problem ka bërë Dr. Kuentin Tomson për llogari të qeverisë shqiptare( Gazeta Dita 23. 02. 2014) dhe çfarë ka dalë? Indeksi h-mesatar që mat nivelin shkencor të stafit akademik për një pedagog të F. SH. N-së (më i vjetri e më i miri në Shqipëri) nuk e kalon shifrën 2, ndërkohë që në Perëndim, stafi akademik nuk punësohet me kohë të plotë pa patur së paku indeksin H- në shifrat 10-12. Përfytyroni se çfarë koeficientësh do të kenë ata pedagogë



të jashtëm (mjekë, jurist, prokurorë, policë, agronomë, inxhinierë, ekonomistë, bankierë, etj) pa një kualifikim didaktik e që marrin guximin e lektorojnë nëpër auditore? Mary Mycaleese- ish presidente e Irlandës, tani president e grupit të nivelit të lartë të BE për modernizimin e arsimit të lartë vë theksin:

Një kërkues i ri ka nevojë për trajnim të zgjeruar për të arritur mësimdhënien ekselente – thekson ajo. Prandaj instruktivet e cilësisë së lartë janë po aq të rëndësishme për universitetet, sa të themi kërkimet pinonere – përfundon ajo. Aktualisht kjo është edhe më imperative në universitet tona, në një kohë që rekrutohen si mësimdhënës gjithfarë individësh të profesioneve nga më të ndryshme për nevoja të fakulteteve apo departamenteve, pa kurrëfarë aftësish didaktike, të cilat domosdo duhet të kualifikohen më standartet bashkëkohore të të mësuarit.

Reforma në ridimensionimin, rivlerësimin, krijimin dhe zhvillimin e një numri të konsiderueshëm teorish dhe strategjish të reja të të mësuarit që nxisin të menduarit e të vepruarit aktiv, ripozicionimi i rolit dhe misionit të pedagogut nga burim informacioni apo transmetues i thjeshtë dijesh, në menaxher e moderator i procesit mësimor për modelimin e formimin e kompetencave si kapacitete për të bërë gjëra, ripozicionimin e statusit të studentit nga qenie pasive në një qenie aktive duke e vendosur atë në qendër të skemës për vetëformimin e tyre nëpërmjet kërkimit dhe hulumtimit individual dhe në bashkëveprim me të tjerët, rimodelimi i një lidhshipi akademik si personalitete me integritet të lartë shkencor, moral e profesional, krijues me inisiativë (jo mediokër e dogmatik) vizionar që e sheh agimin më herët se të tjerët, kundërkonformist (jo servile e i nënshtruar) për përsosjen e realitetit ekzistues që nëpërmjet gjenerimit të ideve të reja dhe ndjeshmërisë ndaj progresives, të fokusojë me autoritetin e vet akademik, moral, shkencor e profesional të gjithë sinergjinë e stafit (pedagogë e studentë) në projekte, role, reforma e vizione drejt një perspektive të qartë e të suksesshme të institucionit që drejton janë këto standarde që e bëjnë një universitet cilësor dhe funksional duke bërë që ky universitet të ndryshojë logjikën dhe filozofinë e funksionimit të tij: jo universitet të japë ofertën e komanduar nga lart, por një ofertë të integruar me kërkesat e tregut dhe shoqërisë në bashkëpunim me ata të cilët janë konsumatorë të këtyre produkteve humane. Standardet e mësipërme garantojnë brenda kësaj logjikë e filozofisë të universiteteve dhe një standard të lirisë së studentëve, i cili vetë formaton programin e studimeve të veta duke i zgjedhur vetë lëndët dhe kurrikulat me një hapësirë maksimale për tu bërë aktor i formimit të vetë profesional dhe menaxher i aftësive të tij intelektuale. Detyra e universitetit është t'i ofrojë studentit mjedis pedagogjiko-shkencor sa më cilësor e fleksibël që ai të veprojë lirisht brenda këtij mjedisi.

Si përfundim mund të theksoj se vetëm një projekt i ri menaxhues dhe administrues që do ta transformonte sistemin e vjetër dhe jo eficient universitar në një sistem universitar model, me kurrikula bashkëkohore, me një staf akademik cilësor real dhe jo OMGJ-akademike, me një sistem informativ modern dhe mbi të gjitha me një

kulturë të re shkencore dhe civile në të gjitha drejtimet dhe aspektet e veprimtarive universitare, me një filozofi të re të të mësuarit, të të menduarit e të vepruarit si dhe me krijimin e mjediseve dhe kushteve të përshtatshme për stafin e studentët do të mund të realizonte edukimin e personaliteteve të së nesërme me plotë të panjohura e të papritura të paparashikueshme, të cilët të jenë të aftë jo vetëm si specialistë të një fushe të caktuar, por edhe organizator, udhëheqës, drejtues të proceseve teknologjike e shoqërore iniciator dhe përcues të mendimit shkencor, ndërkaq edhe cilësi të veçanta intelektuale si konformist, luftëtar energjik për përsosjen e realitetit, si qytetar të formuar me normat e standartet e demokracisë e së të drejtës, të cilat do ta konsideronin shërbimin e tyre për shoqërinë si problemin madhor të jetës së tyre. Me personalitete të tilla të formuara në universitete, a ka ndonjë që e vë në dyshim progresin dhe modernizimin e shoqërisë sonë? Kjo kërkon përveç atyre që përmendëm më lart, nga pikëpamja organizative, zbatimin krijues e shkencor të Reformës, të monitoruar në mënyrë të rreptë në bazë treguesish konkretë, duke mobilizuar të gjitha burimet e mundshme financiare, materiale, njerëzore dhe institucionale. Po kështu do të kërkohej sensibilizimi i të gjithë shoqërisë që nga vendimmarrësit tek biznesmenët e deri tek qytetarët e thjeshtë për domosdoshmërinë e dobinë e cilësisë së diplomave universitare, sepse ka munguar dhe vazhdon të mungojë vizioni, organizimi dhe bashkëveprimi i të gjitha qarqeve të specializuara arsimore, shkencore e pedagogjike me ato afariste ku problemet e arsimit dhe shkencës e zgjidhjet praktike të tij nëpërmjet reformave të reja arsimore e shkollore t'i nënshtroheshin analizës, diskutimit debateve të herëpashërme të gjëra e të hapura ku të merrnin pjesë të gjithë subjektet politike, ekonomike, shkencëtare, akademike, profesore, mësues e prindër, të interesuar për arsimin e shkollën, për gjendjen, nivelin, efektshmërinë dhe fatin e tyre në të ardhmen dhe mbi bazën e këtyre veprimtarive të hartohet një platformë arsimore strategjike e miratuar nga të gjithë dhe e paprekshme nga çfarëdo force politike që do të fitonte pushtetin. Kjo platformë, kjo strategji duhet të kthehet në një dokument shtetëror, e cila do të përbënte Doktrinën e Reformës për modernizimin e sistemit Arsimor. Dhe kjo është e kuptueshme është e kuptueshme se studentët dhe familjet e tyre sot synojnë dhe kërkojnë natyrshëm një arsim bashkëkohor dhe duan të jenë të sigurtë dhe të bindur për investimin që bëjnë në stadin final të diplomimit të tyre, sepse që të punësohesh sot e në të ardhmen në ndërmarrjet private serioze, projekte apo organizma ndërkombëtare, këtu apo kudo qoftë jashtë vendit, kërkohen aftësi dhe merita të provuara. Dhe sidomos të porsadiplomuarit mund t'i dëshmojnë kryesisht në saj të dijeve që kanë fituar në universitet të cilat kur janë solide dhe bashkëkohore mundësojnë integrimin dinjitoz dhe të shpejtë në botën e sotme globale. Ne nuk e dimë evolucionin e kësaj bote. As evolucionin e shkencës, por treguan se pa të ardhme të universitetit nuk ka të ardhme të shoqërisë moderne. Është më se normale që një pjesë e juaja do ta konsideronte të padobishme këtë shtresë, sepse shumë pohime mund të jenë të përzëshueshme edhe



nga fakti se në botën reale shqiptare ashtu siç paraqitet ajo sot nuk do t'i korrespondojnë asgjëje. Në një sistem demokratik dhe sidomos në një institucion akademik, të shprehesh është jo vetëm një e drejtë, por edhe një domosdoshmëri, një "detyrë intelektuale" që gjithkush duhet ta ndjejë përgjegjësinë brenda komunitetit ku punon – K. Popper, sepse më e rëndësishme është të kuptohet se konfrontimi demokratik është një ballafaqim idesh, programesh, projektsh dhe se është normale që të kemi pikëpamje të ndryshme. Për këtë mjafton të shprehesh. Sapo një njeri ka një përfytyrim racional, të qartë për një problem të caktuar, pavarësisht se prej kujt determinizohet, ai është i motivuar të shprehet dhe

është shumë afër realitetit se sa një tjetër i cili nuk ka një përfytyrim të tillë. Në instancë të fundit secili e di se sa pak di! Edhe që idealet është e pamundur të përshfaqen në botën reale, këtë e dimë të gjithë. Por unë i përmbahem thënies së një filozofi sipas së cilit ne kufizohemi në pohimin se realiteti duhet të gjykohet duke u nisur nga idealet dhe të modifikohet nga ata që ndihen të aftë për ta bërë këtë. Natyra dashamirëse i ruajtë ata dhe u dhëntë atëherë kur i duhet shiun dhe dritën e diellit, u dhëntë një ushqim të mjaftueshëm dhe një jetë të qetë vegjetative dhe veç kësaj edhe pak mendje intelektuale.

### **Bibliografia**

Ajnshtajn, A. , Pikëpamjet e mia, Tiranë, 2005, f. 43-44.

Weber, M. , Politika si profesion, shkenca si profesion, Tiranë, 2006, f. 104-110.

Ppoper, K. , Për filozofinë dhe shkencën, Tiranë, 2009, f. 168-170.

Piter, J. , Misioni i intelektualit, Tiranë, 2011, f. 22, 42.